

MAJLINDA BUSHAJ

FRAZELOGJIA POPULLORE NË VEPRËN *KARPA TË MARTIN CAMAJT*

Martin Camaj është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqiptare i cili dallohet për vlerat e prurjet e shumta. Ai zhvilloi veprimtari krijuese të shumanshme, si albanolog, si gjuhëtar e studiues i historisë së shkrimeve dhe letrave, si ligjërues i dijeve albanologjike, si poet e prozator. Veprat e tij në fushën e gjuhës së sotme dhe asaj historike, e ndihmojnë autorin në përzgjedhjen e leksikut të veprës së vet letrare. Vepra e Camajt përveç leksikut të pasur, njih edhe një përdorim të dendur frazeologjisë si gjuhësore apo letrare, të cilat i japin gjuhës së veprës së tij një forcë të madhe ndikuese.

Ashtu si veprat e tjera në prozë romani *Karpa* cilësohet me një sistem të ngritur e të përpunuar të shprehësisë artistike, me gjuhë të zgjedhur e me frazeologji e idiomatikë të pasur. “Raporti i leksemave brenda fjalisë dhe frazës, strukturës tekstore është i atillë që ato shprehin, edhe shumësinë kuptimore, edhe maksimumin kuptimor duke krijuar një nyjetim të pafund kuptimesh.”¹ Gjuha e Camajt është shumë e pasur me njësi frazeologjike. Duke e analizuar edhe në pikëpamje sasiore, konstatohet se ajo tejkalon dukshëm mesatares 2 njësi frazeologjike për faqe të veprës që po analizojmë. Kështu në 200 faqet e romanit kemi vjelë mbi 400 njësi të tipave të ndryshëm.

Frazeologjia e tij është e pasur dhe shumë origjinale. Camaj e njëjtte mirë jetën e malësorëve ndaj shfrytëzoi për shprehësi frazeologjinë popullore. Tek Camaj përdorimi i frazeologjisë vjen si nevojë e karakterizimit etno-psikologjik të mjedisit, të personazheve, të skenave etj. Leksiku i veprës së tij na sjell botën shpirtërore e materiale të Dukagjinasve e arbëreshëve, Shkodrës, fshatrave të Malësisë etj. Vlerat janë të dyfishta semantike dhe mbishtresore, me një ngjyrim të theksuar emocional, të cilat autorit i vlejnjë si lëndë e pazëvendësueshme në krijimtarinë e vet letrare, me shtresëzime historiko-kulturore, duke sjellë mendësinë krahinore e mbarë shqiptare, ai përshkruan personazhe e pamje të jetës shqiptare me ngjyresë historike, me veçori gjeografike e natyrore, me tipare folklorike e etnologjike, me pasurinë shpirtërore, me mendësinë, kulturën, psikologjinë e filozofinë e gjithçka tjetër që përbën botën shqiptare. Nisur nga kjo, frazeologjia e tij shquhet për përmbajtje të gjerë e të thellë, figuracion të pasur, ngjyrim të fortë

¹ A. Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, Tiranë, 2010, f. 120.

emocionues. Në veprën e Camajt dallohet lidhja me gjuhën popullore, talenti vetjak, njohja e pasurisë kombëtare e ndërkombëtare.

Frazeologjizmat me burim popullor përbëjnë pasurinë kryesore të frazeologjisë së gjuhës shqipe. Duke u mbështetur në thënien e Thomait "...në këtë frazeologji më shumë se në fjalët e veçanta, shfaqet veçoria kombëtare e gjuhës, historia e zhvillimit të saj."² po paraqesim disa frazeologjizma që paraqesin interes:

e humbi sysh plakun i shpëtoi pa e vënë re "Voni, ndërkohë që i kishte sjellë sytë te krushku i vet **e humbi sysh plakun**, jo krejt: i pau vetëm majën e kokës tue u zhdukë nën breg, rrugës nën drejtim të lumit." (Karpa:11);

si me krye në thes në rrezik të madh, pa e ditur se çë keqe më pret, me rrezik jete pranë. "Si me krye në thes qëndronte barnatari në kambë buzë Drinit, zemërthym sepse, pos se martohet me një vajzë të panjostun, atij në Karpë pa mbërritë atje, i kish pri zani i keq, se qenkej spiun i fisit të vet." (Karpa:7); "Më ngashëron puna që të mitë më kanë dëbue këndeje **me krye në thes**." (Karpa:42).

t'i bjerë për fije i ra pikës "Në tanësi binaja ka trajtë anije, katedralje u përpoq Barnatari **t'i bjerë për fije**." (Karpa:31).

me gjak e lak me këmbëngulje; me kokëfortësi; pa asnjë lëshim; me dhunë me mënyra e me mjete të ashpra, me forcë, me terror. "Dikujt po i lypet **me gjak e lak**, të kërkojë një emën fare të ri që mos të quhet ashtu si para grindjes së përgjakshme." (Karpa:161).

pa shej pa dukë (u zhduk) pa lënë asnjë gjurmë. "**Humbën pa shej pa dukë**, u dogjën me hiri ose pahiri gjatë rrënimit të parë të Qytezës ashtu si ishin gjithëmbarë në rafta, apo ndezën zjarmin me ta ma vonë për të gatue ushqim për luftarë në fazën e dytë të kryengritjes, nuk dihet." (Karpa: 181).

ia bleu në gjak të fytyrës e kuptoi nga mënyra e të thënit. Kjo shprehje frazeologjike nuk gjendet në Fjalorin e Thomait, as në Fjalorin e 1980. "Romancieri **ia bleu në gjak të fytyrës** se çka i shkonte ndërmend shmirjakut plak që ndoshta dëshironte që ashtu të kish sosë historia e kobojasit." (Karpa: 100).

s'ke pse i matesh malit me sëpatë thuhet për diçka që është e pamundur të bëhet, kur ka një pengesë madhore që nuk mund të kapërcehet kurrsesi "S'ke pse i **matesh malit me sëpatë**- ia priti ajo, gati me i trashë fjalët." (Karpa:75).

mos e trazo gjarprin kur pi ujë ruaju nga armiku edhe atëherë kur të duket se është i parrezikshëm "Njerëzit vijnë në eufori darsmore – shkundi kokën Shkriba dhe zhgënjimi i papritun ban e i qet mendësh e të zë rreziku, me siguri... Rueju! **Mos e trazo gjarprin kur pi ujë!**" (Karpa:198).

si me kërkue gjilpanën në dushk kërkon gjilpërës në kashtë, kërkon kot, kërkon diçka që nuk mund të gjendet "Po dalim – u përgjigj Romancieri, – po mos na pritni shpejt; ashtë si me kërkue **gjilpanën në dushk**." (Karpa: 102).

² J. Thomai, *Aspekti shoqëror-kulturor në formimin e frazeologjisë shqipe*, SF, 1975/3, f. 116.

Frazeologjia popullore në veprën *Karpa* të Martin Camajt

pa i ra syut qepallë e shikonte trimërisht, pa frikë “*Shtrohej përdhé kinsë tue ia përsjatë qëndrimin të njeriut të egër të paleolitit dhe e nxirte atë flakëz prej landës përkushtueshëm dhe sikur ta kishte qitë prej barkut të vet e shikonte pa i ra syut qepallë nja disa minuta.*” (Karpa: 144).

mos me t’i zanë syni shumë i vogël, që nuk shihet “*Aty për aty po në atë anë mori me thye lehtas fije kullomash gëlqerorë; fije fije e grimca grimca derdheshin nëpër gishta të tij; mes tyne shkëndija kristalesh të vocrra sa mos me t’i zanë syni; së pari ndjeu diçka në lëkurën e gishtave, si të ishte tue prekë flakën.*” (Karpa:144).

si pulën në furrik i shushatur. Kjo shprehje frazeologjike nuk gjendet në *Fjalorët* e shqipes. “*Ashpërsia e vume në lëvizje prej erës i rritej ndër sy, shprehte kërcnim dhe lypte gjakmarrje, gjakun e tij të ngujuem në shkamb, me dredhi i qitun në kurthë, edhe ma keq se në kurthë: pos se e paskan qitë me të katërta mbrendë, e kishin poshtnue e degradue ta kapnin kurdoherë si pulën në furrik edhe tue e torturue shpirtnisht të zhgënjehej të priste se andej kah mund t’i vinte një ditë shpëtimi, do t’i ulej vdekja.*” (Karpa: 134).

tue i lanë shteg gjasës i hapi rrugën diçkaje, e vë në dyshim, jap mundësi të kryhet diçka “*Rindërtonte përsëri skenën e uljes së sendeve tue i lanë shteg gjasës se Paraardhësi nuk paska qenë në gjendje t’i zbriste teposhtë pa ndihmë të ndokuj tjetër gjithë ato plaçka në një kohë aq të shkurtë.*” (Karpa: 135).

ta vejë përfije e vë në rregull, e vë në vijë “*Rinia duhet ta vejë përfije gjendjen.*” (Karpa:167).

Karakteri popullor i frazeologjisë duket si në pikënisjen e ndërtimit të njësive frazeologjike, ashtu edhe në anët e tjera të tyre. Gjymtyrët kryesore të njësive frazeologjike janë fjalë që shënojnë pjesë të trupit, ose fjalë të jetës së përditshme. P.sh. si gjymtyrë drejtuese shërbejnë fjalët: **sy, dorë, mendje, zemër, gjak, këmbë, qafë, fjalë, gojë, vesh, shtat, gjak** etj.

Vetëm me fjalën **sy** në këtë roman ndeshim 34 shembuj si: **sa për sy e faqe** sa për tu dukur përpara të tjerëve, për të parë e për të ditur të tjerët; **e humbi sysh plakun** i shpëtoi pa e vënë re; **mu morën syt** gënjehem pas dikujt a diçkaje, nuk e vërej mirë; (e sheh) **me një bisht syni** (dikë)nuk e vlerëson siç e meriton, e nënvlerëson, e përçmon; **ishte therrë në sy** nuk e shoh dot me sy, se duroj dot e përbuz; **sy më sy** ballazi, në sy; vetëm për vetëm me dikë; **sa çelet e mbyllet syni** shumë shpejt, për një kohë shumë të shkurtër; menjëherë; **nuk u besoj syve** çuditë shumë kur shoh dikë a diçka që nuk e prisja, habitem a befasohem; s’më besohet; **e ruante si sytë e ballit** e kam si gjënë më të shtrenjtë, kujdesem shumë për të dhe e mbroj nga çdo e keqe ose cenim; **ke pa andrra me sy mbyllë ose të hapun** dëshira e synime të kota jashtë çdo mundësie, përfytyrime ose sajesa me fantazi që nuk mund të plotësohen asnjëherë; ëndërrime të kota, sajesa; **më kanë ba sytë** më duket, ashtu më duket, më bëhet sikur, më ngjan sikur; **hiqu sysh** largohu nga unë e mos më dil përpara; **kokërr ndër sy** nuk i trembet syri, është guximtar, është krenar; **iu kapën sytë; me veshë e sy të mbyllun; mos t’i dalë sysh; i binte në sy;** (të duket) **në sy të botës; t’ia përplas ndërsy; s’ia kishte**

mbushë kurrë synin; pa u ra syve qëpallë; ia rrokte syni; i rritej ndër sy; sa mos me t'i zanë syni; e morën nga fillimi me sy të keq; për të çelë sytë; me u ngi sysh me to; të kullohem si loti i synit; me sy peshku etj.

Dorë: i delte dore; nuk vuni dorë; qenke i lëshuem dore; e lëshon dore; s'e vë dorën në zjarm; s'u shkonte për dore etj.

Dhe: nuk iu suell ma dheu, si me i pasë përpi dheu, sikur të kishin mbijhtë nga dheu etj.

Dreq: fol për dreqin dhe dreqi mbas dere, i këcyen dreqnit, s'ka dreq që i ndalë etj.

Fjalë: fjalë mbas fjale, fjalën e nderit ia dha, e mori fjalën, pa u shty fort në fjalë, s'i bie në fjalë, e pat qit fjalën, e kanë hangër barijtë fjalën, me ua vu veshin fjalëve të botës, (me) i ra në fjalë, iu ngjit fjala për fyt e mbet me gojë hapët, ia preu fjalën, (të gjithë) një fjale etj.

Gojë: goja i pret si s'ke me të, i zë kush në gojë, një fjalë goje, s'e hapnin kurrë gojën, ta kish marrë në gojë etj.

Gjak: me u vu gjaku për gjak, bani gjakun e dheut, me gjak e lak, gjaku ujë s'bahet, nuk bie në gjak etj.

Kambë: me një kambë nën dhë, që ju mban në kambë, në kambë e në dorë, kish vu kambë, mblodh cung kambë e krye, ku u bie kamba, pa u hy therrë në kambë, me kambë të mbarë etj.

Kokë: t'ia lidhë kryet (një problemi); s'do të qesim kryet gjallë; si pula pa krye; në krye të kresë; se e qet kryet atje shëndosh; për t'u hangër kryet; to qitnin krye; më hyn në krye; do ta lanë kryet; t'ia lidhte kryet; si me krye në thes etj.

Qafë: këput qafën; hiqmu qafe; i paskëshin ra trutë në qafë; e pastë veten në qafë; ka thye qafën etj.

Zemër: e lëshoi pakëz zemra; i ngrehte zemra; i shtjerrun zemre; ia ndjeu zemra; ia kishte pushtue zemrën; dyshë kish me m'u ba zemra; iu fry pakëz zemra; ia çoi zemrën peshë; s'ia bante zemra; e paska ndie në zemër; zemra ua ngrehte etj.

Nga këto njësi frazeologjike të përdorura në veprën e tij pjesa më të madhe e përbëjnë njësitë frazeologjike foljore. Ky përdorim kaq i shpeshtë i njësive të tilla frazeologjike vjen për dy arsye: së pari, për arsyen e thjeshtë objektive se prania e veprimit a gjendjes në fjali, e shprehur nga folja, është kurdoherë e nevojshme, sepse ai përfaqëson gjymtyrën ndërtuese kryesore më të domosdoshme, kallëzuesin, e shprehur në këtë rast me një frazeologji foljore, por jo pak edhe për një arsye të dytë subjektive: prirjen e dukshme të Martin Camajt për të përdorur, jo rrallë, për shumë folje, gjegjësen frazeologjike të saj, tek e cila ka një shënues jo të drejtpërdrejtë të veprimit,

me një kuptim që ka në bazën e vet një thelb metaforik të përfutur nëpërmjet metaforës, dhe, si e tillë, me fuqi shprehëse të veçantë.³

Një vepër gjendet një numër i madh njësisish frazeologjike foljore, prej të cilave kemi shkëputur disa shembuj, si: **të merresh vesh** të kuptohet mirë me dikë, pajtohem me diçka, **i plasi tamthi** i dhemb koka shumë nga një punë mendore, nga zhurmat, nga telashet, **ia preu mendja** e kuptoi diçka, e **more me mend** e kujtove diçka, **dolën në dritë** u zbulua, u shfaq; u bë e qartë për të gjithë e vërteta, e **ke dhanë fjalën** i premtoj, e siguroj dikë për diçka, **i hapeshin sytë** ka filluar ti shohë gjërat ashtu siç janë në të vërtetë; e ka zbuluar të vërtetën, e **bante me lujt mendsh** e çmendti, e shkalloi, **ngulte këmbë** kërkoj me të madhe që të më plotësohet një dëshirë, nuk tërhiqem, **këput qafën ku të duesh** ik shporru, **më binte në qafë** më shqetëson pa të drejtë, më ngacmon kot e më mërzit etj.

Për nga ndërtimi paraqesin një larmi strukturash, që nga togjet e qëndrueshme dykryegjymtyrëshe e deri ato shumëgjymtyrëshe, nga ndërtimet në trajtë fjalie e deri ato në që janë afër fjalëve të urta, si: **drapnit në thes i del maja përjashta** e ndeshim tek Thomai *mban draprin në thes e majën jashtë* = (dikush) është njeri i djallëzuar, që kërkon të bëjë një të keqe fshehurazi, por nuk fshihet dot. (Thomai: 90); *Dyshimet e mbledhuna fije fije gjatë kohës që kishte kalue në Karpë e kryekreje ndërkohë që kishte ra aty mbrendë i kapi era e thatë dhe endi me to pëlhurën e mosbesimit të plotë, të sigurisë se ishte pulë e lidhun për laku në furrik, korb i ndrymë në kafaz.* (Karpa: 134) etj.

Njësitë frazeologjike ndajfoljore vijnë për nga sasia pas grupit frazeologjik foljor. Njësitë frazeologjike ndajfoljore dalin me dy tipa strukturorë: frazeologji të formuara nga përsëritja e së njëjtës fjalë dhe frazeologji të formuara nga dy fjalë me lidhje kuptimi, të bashkërenditura ose të nënrenditura, si: *me vjet e vjet, kulm e themel, për jetë të jetës, cip më cip, natë as ditë, vesh në vesh, me mish e me shpirt, krah e krah, sa çelet e mbyllet syni, me gjak e lak, hundë e në buzë, fund e maje, gju për gju, në katër anët* etj.

“Kundër andrrës apo vegimit të sëmunë fliste edhe puna se në filmat e vrojtun në shtyllën e erës, përkonin përpiktas, cip më cip, përpjestimet e objekteve, pos në një skenë ku një dhi me gojën e saj të ngushtë përpinte kokën e një kau.”(Karpa: 26). *Rrinë gju për gju me lugetën e pinë venë!* (Karpa: 189) etj.

Në njësitë e grupit të dytë dalin njësi frazeologjike të ndërtuara me elemente krahasuese, kryesisht njësi frazeologjike që nisin me lidhëzën *si* dhe

³ Thanas Feka, *Pasuria frazeologjike në krijimtarinë letrare të Martin Camajt*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Martin Camaj në kulturën shqiptare” mbajtur në Tiranë me rastin e 85 vjetorit të lindjes, nga Qendra e Studimeve Albanologjike (Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë), më 24 shtator 2010. Këtë punim (në dorëshkrim) e kam marrë (me kërkesën time) nga vetë autori. Këtu autori ka bërë objekt trajtimi nga proza e Camajt romanin “Rrathë” dhe poezitë e botuara në: Martin Camaj, *Vepra letrare* 1, 2, 3, Tiranë, 1996.

sa dhe ndërtime frazeologjike që nisin me parafjalë, si: **si terri e drita** shumë shpejt menjëherë “Vetëm ngjyra që ka, Qytezës për jetë të jetës si hiqet, ndërsa fatkeqësia i shkon e i vjen **si terri e drita**.” (Karpa:28); *E marr me mend, në fillim ke me u mërzitë vetëm, ndoshta do të bahesh depresiv, po vare në vesh çka po të thom: je barnatar i lidhun me natyrë **si mishi me thue**.* (Karpa: 113); *Tjerë dhe tjerë i ngjiteshin dërrasës përpjetë **sa mizë për kërcunë**.* (Karpa:121); *Në atë pikturë floreale, trajtat e përvijat e shtëpive zhdukeshin **si krypa në ujë!*** (Karpa:76); (Karpa: 82); *Por kjo nuk do të ngjante u shkri Karpa **si shkrepçë në flakën e vet**.* (Karpa: 85); *Hapat i ndërron me vështirësi, por goja i pret **si s'ke me të!*** (Karpa: 61) etj.

Njësitë frazeologjike mbiemërore janë më të pakta, megjithatë këto frazeologji duke u përdorur si epitete me një ngjyrim të theksuar emocional, shërbejnë si mjete me vlerë stilistike. Në veprën Karpa ndeshim të përdorura tipa të ndryshëm strukturorë, si: **shpatë me dy teha, me një kambë nën dhë, pa pikën e shpresës, me sy peshku, si pula pa krye** etj.

*Mbanin njeni tjetrin të mos rrëzoheshin dhe burra e gra të motueme përpiqnin për të parën herë në atë vis të vetmuem krahun për krah; nganin secili ngutshëm e trullueshëm **si pula pa krye** me lexue faqen e zgjedhun nga letërsia botnore, jo në kolektiv, secili veçmas. Këto kur kujtoheshin se ai e gjeti atë ç'kërkonte, kthenin dalë dhe e pritnin **si maca felën e mishit në pritë**, pa ia largue sytë një timtë.* (Karpa:89) etj.

Frazeologjitë emërore janë shumë të pakta në krahasim me llojet e tjera të njësive, si: **gafe mbas gafesh** gabime “Ngase më nisën për dhunë këndeje, shpesh po humb drejtpeshimin, po baj **gafe mbas gafesh**.” (Karpa:42); **shpotitë e pakripë** talljet “Mbas ushtimës së gazit të barijve, u mbush sheshi përsëri me njerëz; vetëm atëherë u kujtuen shmirjakët (të pamësuem me pije alkoolike, u kish dalë delli sa grushti në ballë!) se gjindeshin para kufomave e se aty s'kishin vend **shpotitë e pakripë**.” (Karpa: 95) **kodra mbas bregut** fjalë të marra Mbasi nuk kishin kundërshtime idesh (si kishin me moralizue mbi besnikinë bashkëshortore, kurse ata të dy s'ishin të fejuem, as nuk do të martoheshin kurrë?), të nënshtruem fatit, morën me folë **kodër mbas bregut**, por rrjedhshëm vetëm për të prishë heshtimin.(Karpa:50) etj.

Camaj shquhet për një liri në strukturë e formë, për aftësinë për përpunim gjuhësor e stilistik, në përdorimin e frazeologjizmave të njohura e të panjohura, në përshtatjen e tyre në krijimet e modifikimet e shumta duke ndikuar kështu dukshëm në rritjen e intensitetit të funksioneve shënuese e vlerësuese të tyre. Veçori të ndërtimeve frazeologjike në veprën e Camajt janë: modifikimet e ndryshme të njësive, si: ndërrimi i rendit të gjymtyrëve (inversion), ndërfutja e fjalëve të tjera, zgjerimi a cungimi i njësisë frazeologjike, pa e shpërbërë atë dhe kthimi formal i trajtës mohuese duke ruajtur përmbajtjen mohuese të saj. **Më lësho ma tepër lak** të endem lirisht rreth Qytezës e po të mbledh aq helm sa me helmue një anë dheu. (Karpa:54); *I premtoi kryetares (fjalën e nderit ia dha!)se kurrë ma nuk do t'ia zente në gojë atë punë*

Frazeologjia popullore në veprën *Karpa* të Martin Camajt

dhe iu lut me e lejue ta përcillte të bijën e saj tue u endë nëpër Katund derisa t'i kish kalue dhimba e kalit të rrëxuem. (Karpa:86); *Dhe buza iu var krushkut ma tepër ma tepër deri në neveritje.* (Karpa:8) etj.

Koha në roman është subjektive. Atë nuk e përcakton tërësisht as e kaluara, as e tashmja as e ardhmja, por të tria bashkë. Ajo që ngjet në *Karpa*, që ka ngjarë ose mund të ngjajë është ajo që shprehet në Kronikë, të cilën personazhet e tregimit duhen t'i përshtaten asaj jete. Këtë dukuri Camaj e shpreh mjaft mirë nëpërmjet shprehjeve të figurshme njëra pas tjetrës. Bie në sy si veçori e stilit të Camajt, që ai shfrytëzon me mjeshtri disa njësi frazeologjike njëherësh a njëra pas tjetrës dhe i përdor për të dhënë karakterizime nëpërmjet kundërvënies, ose për të përforcuar e përmbyllur një mendim.

P.sh. *Me fjalë të tjera lypni që të përshkohem si uji i shiut nëpër thëngjij që të kullohem si loti i synit për të qenë i denjë për të jetuar me ju.* (Karpa:12); *Voni u kujtue se me atë njeri të panjoftun e lidhte diçka fatale, vdekja dhe hapi gojën të thoshte se urimet s'do ta banin kurrë të veten sepse ai nuk paskësh ardhë me kambë të mbarë dhe se ia ndiente zemra se një ditë do ta vriste Shkribën me dorë të vet, por Shkriba e mori fjalën ma shpejt nësa i printe dhandrit nëpër fuqi e konopë leqe leqe në skele.* (Karpa:8); *Ti ke idena-vërejtji Kronisti- e askush s'ma mbush mendën se ti nuk e nxjerr helmin edhe prej gurit.* (Karpa:23). *Ndiente se diçka po i delte dore dhe i humbte sysh.* (Karpa:81); *Shiko, tha ky me vete, si ec tue u tundë herë në një krah, herë në tjetrin, me lëvizje aspak krekare, pa ia vu mendën se ku u bie kamba po ashtu si i ka hije një vajze të pakeq që ende s'e di se ka një korp për martesë.* (Karpa:20); *Katastrofa e vogël vetëm rreth plangut me atë shtëpinë guri midis i dha prapë shkas me dyshue se çdo gja që i binte në sy e përkiste në atë ambient qenke kurdisë për ta vu në sprovë.* (Karpa: 27); *Iu morën mendet dhe u ul ndejë në fundin e shkallave mermeri te hymja kryesore; prarë iu ngjii fjala për fyt e mbet me gojë hapët dhe harroi fare se kush e shoqonte në teatër, një grue e pjekun, vetë nënkryetarja e bashkisë, Ajka.* (Karpa:31); *Ndonëse u muer vesh se kishte qenë një katastrofë natyrore, dikujt në Qytezë (plakave rreth gjyshit) u dha shkas të kurdisnin procese gjyqësore për t'u hangër kryet disa rojtarëve në Kopësht.* (Karpa:56); *E shleu nga mbresa Paraardhësin dhe u përqëndruë në përfytyrimin e Romancierit që e kish marrë në qafë përjetë të jetës.* (Karpa:137); *A ta merr mendja se të ndez kërkesa të martosh Borën në kambë dhe në dorë në pikë të natës mbas çka ka ndodhë sot në Qytezë.* (Karpa: 105) etj.

Një përdorim të veçantë kemi kur një njësi frazeologjike i bashkëngjitet një tjetre, ose ndërfitet në të, edhe me këmbim të gjymtyrëve, për të përforcuar përmbajtjen e vet kuptimore dhe emocionuese. Këtu bashkëpërdorimi i njësisve frazeologjike nuk ka shkaktuar bjerrjen e ndonjërit prej përbërësve, si: *I kësaj mendjeje jam edhe unë se ke pa andrra me sy mbyllë ose të hapun.* (Karpa:22); *Me veshë e sy të mbyllun e përshkoi Voni atë vajzë që rryeshëm ia kishte pushtue zemrën.* (Karpa:21); *Drita e kaloi horizontin sa çelet e*

mbyllet syni dhe tue vezullue lëvizshëm si diçka e gjallë zbuloi si erë e fortë trajtën e kurmit të tij të shtrimë. (Karpa: 117) etj.

Në disa raste, kur nga dy njësi frazeologjike është krijuar një njësi e re si nga ndërtimi, ashtu edhe nga kuptimi, njësia e përftuar ruan lidhjet me dy njësitë frazeologjike fillestare, por nuk është e njëjtë me to. P.sh. *Nuk ndërrohen nenet e kushtetutës që ndalojnë me **vu dorë për së gjalli ose për së vdekuni** në Kryetarin e Karpës.* (Karpa: 91) etj.

E reja që sjell Camaj nuk është vetëm pasuria e madhe frazeologjike e gjuhës së tij, por edhe nuancat kuptimore të që ndeshim në shumë frazeologji të njohura. Këto nuanca të reja kuptimore e pasurojnë frazeologjinë shqipe duke zgjeruar përmbajtjen kuptimore të këtyre njësive. Këto raste janë të shumta në këtë roman.

Frazeologjia **mos t'i dalë sysh** përdoret gjerësisht, me kuptimin “të mos largohet pa e vënë re, të mos ikë tinëz” në roman del me kuptimin “të mos e harroj”. “*Sa më tepër sillej shtylla e ajrit të vorbull, aq më tepër përsoseshin shfaqjet tue kalue zi prej filmit bardh e zi në ngjyra lloje-lloje për ta zmadhue në kulm kuben që njeriut edhe vdekë **mos t'i dalë sysh** larmënia e mizorisë së vet.*” (Karpa:26). Frazeologjia e **kapën të dridhunat** përdoret gjerësisht, në zonën e Dukagjinit me kuptimin “e zunë ethet” në roman del me kuptimin “i hyri frika, e humbi qëndrimin a duresën para diçkaje të vështirë” *Plakun e kapën të dridhunat.* (Karpa: 62). Frazeologjia (njeri) **i lëshuem dore** ka kuptimin “njeri që harxhon më shumë sesa duhet, nuk kursen, prish me tepri” Camaj përdor edhe një kuptim të ri “i braktisur, i ndarë nga jeta, nga të tjerët” “*I ngujuem në shkamb s'i bahej me besue se mund të kapej ai ritëm; këndej iu përforcue bindja se qenke **i lëshuem dore** prej gjithë njerëzve.*” (Karpa: 133) Frazeologjia e **qis mendsh** që përdoret gjerësisht me kuptimin “e çmend” në roman ndeshim kuptimin “e harroj diçka, nuk kujtohem për diçka” “*Njerëzit vijnë në eufori darsmore – shkundi kokën Shkriba dhe zhgënjimi i papritun ban e **i qet mendësh** e të zë rreziku, me siguri... Rueju! Mos e trazò gjarprin kur pi ujë!*” (Karpa:198); *Ky se kishte qitë një herë të vetme idenë e saj jashta **mendësh.*** (Karpa:90) etj.

Përveç njësive frazeologjike gjuhësore, në roman ndeshim edhe mjaft të ashtëquajtura “frazeologji letrare”⁴ si shprehje të mençurisë popullore, urime, betime, lutje, proverba, fjalë të urta. Nëpërmjet përshëndetjeve dhe urimeve shqiptare mund të nxjerrim të dhëna me interes rreth të dhëna me interes rreth shoqërisë shqiptare dhe mendësisë së popullit tonë në shekuj siç shprehet Shkurtaaj “zgjedhja e forme të caktuar të përshëndetjes a të urimit jep tregues të rëndësishëm të marrëdhënieve a raporteve sociale të një epoke të caktuar.”⁵

⁴ J. Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 235.

⁵ Gj. Shkurtaaj, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2010, f. 159.

Duke qenë se në urimet sharjet mallkimet vlera shprehëse emocionale është e përhershme, ajo ka sjellë që pikërisht skema e rendit të fjalëve të jetë më e zakonshme në përdorim, për shkak të një fosilizimi më të madh të atyre lidhjeve sintaksore; ndërtimi i tyre me folje të mënyrës dëshirore i përgjigjet ngarkesës emocionale dhe kjo ka çuar në një ngurosje më të madhe të këtyre lidhjeve sintaksore dytësore. Pikërisht te mallkimet, urimet, fjalët e urta, shprehjet të tjera emocionale, del qartë roli që luan ngjyrimi emocional në ndërrimin e rendit fillestar të fjalëve.

Tek Camaj urimet janë të ndërtuara kryesisht nga forma foljore të mënyrës dëshirore, por edhe nga mënyra të tjera si:

P.sh. *Ky ashtë Drejtori – i tha Shkriba Vonit - iu gjatët jeta!* (Karpa f. 57); *Pastë faqen e bardhë!* – uroi Shkriba – prej këndeje Barnatari e ka të lehtë t'i kapet malit ose të dirgjet deri në lumë për të mbledhë bimë e rranjë që i duhen për përziemje barnash shëruese. (Karpa: 203); *Lëshuen za përmbi Lumë dhe pyetën se kush kish vdekë; këndeje u përgjigjen: Gjyshi! “Qofshi vetë!”* i përdhmtuen ata, të bindun se *Plaku kishte mbyllë sytë vetvetiu nga ligështia e moshës së shtyme.* (Karpa: 96); *“Qoftë larg nesh!”* uruen fiset prej ka u pa tymi mbi Qytezë. (Karpa: 96); *Kështu nuk të kemi ndëgjue kurrë tue folë! – Tha ma i vjetri. – E mbara na priftë!”* (Karpa: 101) etj.

Në këtë vepër formimi gjuhësor i urimeve gjen shprehjen jo vetëm me formën a modalitetin e një foljeje, por edhe me sintagma që të cilat semantikisht mbartin vlerën e një urimi, si: *Mirse vjen ti e kush na vjen me kambë të mbarë!* (Karpa: 8); *Ajo sendërtoi aty për aty një plan djallëzor tue marr shkas prej formulës “bashkë derisa vdekja të na ndajë”.* (Karpa: 193) etj.

Një strukturë ndërtimi të afërt me urimet kanë edhe mallkimet, pavarësisht dallimeve të tyre në planin semantik, si:

Shko, hiqmu qafe. (Karpa: 30); *Vaj për ty nëse të merr gjumi gjatë shfaqjes sepse fyen mikëpritësit.* (Karpa: 31); *Krisma e derës që i mbyllet dikuj në shpinë, tha Barnatari, mbetet në veshë sikur nemja e prindit vofsh e mos kthesh kurrë ma në plang!* (Karpa:40); *Ende nuk e ke kuptue, do t'i kishte thanë, se ashtë e domosdoshme që ky të hiqet qafet me helm apo me ndoj mjet tjetër?* (Karpa:44) *Me ndihmë të fisit do të ngriten vetëm pallatet publike, këput e sos!* (Karpa:179) *E vrava, tha, në gjajën time dhe e pastë veten në qafë! dhe në atë timtë i plasi ideja prej lules së ballit me shpejtësi vetime për së kthjelltit.* (Karpa: 139) etj.

Edhe pse fizikisht i ndarë nga vendlindja e atdheu, nga jeta e përditshme e jetës shqiptare, Camaj paraqitet si njohës i mirë i saj. Ai përdor gjuhën e pasur që është ruajtur ndër malësitë tona duke e pasuruar edhe vetë me shumë fjalë e shprehje të rralla e kuptimisht të pasura. Kjo gjë vërehet edhe në sistemin e pasur të përdorimit i shprehjeve proverbiale, i fjalëve të urta të krijuara nga autori sipas gjelleve popullore, si: *Drapnit në thes i del maja përjashta.* (Karpa:9); *Koha asht letër e bardhë,* thotë një fjalë e urtë në Karpë, mori me arsyetue Shkriba. (Karpa:9); *Ah, mos ia merr për të madhe!* (Karpa:11); Eh,

po, *shto miell, shto ujë...* po a qenka e domosdoshme të shkruhet gjithçka ngjan mes grave e burrave andej e këndej Lumit?” (Karpa: 43); Drejtori tundi kryet “*fol me ju e rruej ve*” tha me mosbesim dhe i priu vizitorit nëpër kthinave të shtazëve, ndá përpiktaz si mbas madhësisë që përkonte dhe me ndamjen në raca. (Karpa:59); Në vesh ndokush i pëshpëriste: vjen koha të thërrasim përnjëmend Magjistar; *prit, pranverë se del bari*. (Karpa:81); Me ujë - ndërhyini Voni-nuk kemi pasë të bajmë as unë, as Shkriba të cilit s’po due me i dalë zot, por po flas që *mos të shkojë i njomi nëpër të thatit*. (Karpa: 92); *Të dalë ku të dalë!* – vërejti ma plaku. (Karpa: 101); *Një rrugë e dy punë*, tha, në një anë lëshoj vendin prej fundërrinave që bien poshtë, e në tjetrën po punoj një kthinë ku mundem me banue sadopak gjatë kohës që ka zjarm në votër. (Karpa: 145); *Të rrimë shtrembët e të flasim drejt!* (Karpa:161); *Mos e trazò gjarprin kur pi ujë!* (Karpa:198); Dijetarët e kohës këtë dukuni e shpjegonin me një thanie kinse të stërllashtë: *ku s’ka -mica s’ka as mij* dhe e mbyllnin kuvendin me kaq. (Karpa:55) etj.

Ky roman është i pasur me këto njësi, kryesisht me burim metaforik, që i japin asaj dinamikë, gjallëri e pasuri semantike e stilistike. Nga pikëpamja strukturore frazeologjia letrare në të shumtën e rasteve është në fazën kalimtare e të figurshme përmes metaforizimit dhe e ka burimin te togfjalëshat e lirë, shpesh me gjymtyrë të shpërndara në njësi të tjera apo me ndërfitje gjymtyrësh të tjera në to.

Nga të gjitha këto shihet se frazeologjia është një dukuri e spikatur për gjuhën e Camajt, ka gjetur përdorime me vlera të shumta kuptimore, stilistike e shprehëse. Kjo përbën një nga tiparet e stilit të tij, realizuar me mjeshtëri, në pajtimit të plotë me rregullsitë e gjuhës. Në këtë mënyrë gjuha në veprën e tij merr forcë të veçantë, ndër të tjera edhe nga pasuria e madhe e këtyre njësisë. Në të njëjtën kohë krijimet, rindërtimet e përpunimet vetjake, si dhe përdorimet shumë të goditura dhe funksionale japin një ndihmesë të re për përpunimin e frazeologjisë shqipe.

BIBLIOGRAFI

- A. Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, Tiranë 2010.
 AA VV, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, bot. i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), Tiranë 1980.
 AA VV, *Fjalor i shqipes së sotme*, bot. i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2006.
 D. Luka, *Martin Camaj-Mjeshtër i fjalës shqipe*, Studime gjuhësore XIII, Shkodër, 2011.
 Gj. Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2010, f. 159.
 J. Thomai, *Aspekti shoqëror-kulturor në formimin e frazeologjisë shqipe*, SF 3/75.
 J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë 1981.
 J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë 2010.
 J. Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.
 Martin Camaj, *Karpa*, Roma, 1987.
 V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.